REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

P R O J E K T L I GJ

Nr. _____/2026

PËR

"PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE MINERARE"[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka si qëllim krijimin e një sistemi të menaxhimit të mbetjeve minerare për të:
a) parandaluar ose pakësuar krijimin e mbetjeve minerare dhe ndikimet negative të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut;
b) garantuar depozitimin e sigurt të mbetjeve minerare gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre, përfshirë edhe fazën e pasmbylljes;
c) promovuar ripërdorimin, riciklimin dhe shfrytëzimin e mbetjeve minerare si burim dytësor;
ç) parandaluar aksidentet e rënda nga objektet e mbetjeve minerare dhe minimizuar pasojat e tyre;
d) siguruar rikultivimin dhe rehabilitimin e territorit të prekur nga veprimtaritë minerare.

[1] Ky ligj është i përafruar plotësisht me Direktivën 2006/21/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 mars 2006, për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse dhe që ndryshon Direktivën 2004/35/EC (OJ L 102, 11.4.2006, f. 15–34)

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për menaxhimin e mbetjeve minerare, duke përfshirë:
   a) parandalimin ose pakësimin e krijimit të mbetjeve minerare;
   b) depozitimin, trajtimin dhe asgjësimin e sigurt të mbetjeve minerare;
   c) klasifikimin e objekteve të mbetjeve minerare sipas nivelit të rrezikut;
   ç) parandalimin e aksidenteve të rënda dhe menaxhimin e emergjencave;
   d) rehabilitimin e territoreve të prekura;
   dh) monitorimin e pasmbylljes dhe kujdesin e mëtejshëm.
2. Ky ligj zbatohet për të gjitha mbetjet minerare që krijohen gjatë:
   a) kërkim-zbulimit të vendburimeve minerale;
   b) nxjerrjes, shfrytëzimit dhe përpunimit të mineraleve;
   c) nxjerrjes, shfrytëzimit dhe përpunimit të torfës;
   ç) depozitimit dhe menaxhimit të mbetjeve minerare.
3. Përjashtohen nga objekti i këtij ligji:
   a) mbetjet radioaktive, të rregulluara me legjislacion të posaçëm;
   b) inertet e gërmuara të përdorura për qëllime ndërtimi në gjendjen e tyre natyrore.
   c) mbetjet hidrokarbure.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Shteti" është Republika e Shqipërisë.
2. "Ministria" është ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare.
3. "Ministri" është ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.
4. "Mbetje inerte" janë mbetjet e veprimtarisë minerare, që nuk i nënshtrohen transformimeve të rëndësishme fizike, kimike ose biologjike dhe nuk shkrihen, nuk digjen, nuk reagojnë kimikisht, nuk biodegradohen dhe nuk ndikojnë negativisht mbi materialet me të cilat vijnë në kontakt në mënyrë që mund të shkaktojnë ndotje mjedisore ose dëm ndaj shëndetit të njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte janë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore.
5. "Objekt mbetjesh minerare" është çdo zonë e caktuar për grumbullimin ose depozitimin e mbetjeve nxjerrëse, qoftë në gjendje të ngurtë ose të lëngshme ose në tretësirë ose suspensione, për periudhat kohore të mëposhtme:
   -pa periudhë kohore për impiantet e mbetjeve të Kategorisë A dhe impiantet për mbetjet e karakterizuara si të rrezikshme në planin e menaxhimit të mbetjeve;
   -një periudhë prej më shumë se gjashtë muajsh për impiantet për mbetjet e rrezikshme të gjeneruara në mënyrë të papritur;

-një periudhë prej më shumë se një viti për impiantet për mbetjet jo të rrezikshme jo-inerte;
-një periudhë prej më shumë se tre vjetësh për impiantet për tokën e pa ndotur, mbetjet jo të rrezikshme të kërkimit, mbetjet që vijnë nga nxjerrja, trajtimi dhe ruajtja e torfës dhe mbetjeve inerte.

Impiante të tilla përfshijnë çdo digë ose strukturë tjetër që shërben për të përmbajtur, mbajtur, kufizuar ose mbështetur ndryshe një impiant të tillë, dhe gjithashtu përfshijnë, por pa u kufizuar në, stoqe dhe pellgje, por duke përjashtuar boshllëqet e gërmimit në të cilat mbetjet zëvendësohen, pas nxjerrjes së mineralit, për qëllime rehabilitimi dhe ndërtimi.

6. "Operator" është personi juridik ose fizik që ushtron veprimtari biznesi, i cili është përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve minerare, përfshirë transportin dhe depozitimin e përkohshëm të tyre, për operimin e vendit të depozitimit dhe për gjendjen e tij pas përfundimit të operimit;
7. "Mbetje sterile minerare" janë mbetjet e ngurta ose në formë llumi që rezultojnë pas trajtimit dhe përpunimit të mineraleve nëpërmjet proceseve të ndarjes, si thërrmimi, bluarja, klasifikimi sipas granulometrisë, flotacioni dhe teknika të tjera fiziko-kimike, për të ndarë mineralet e dobishme nga materiali shkëmbor me vlerë më të ulët ekonomike. Në kuptimin e këtij ligji, kudo që përdoret termi "mbetje", do të nënkuptojë termin "mbetje sterile minerare"
8. "Substancë e rrezikshme" është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me pirje për t'u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme.
9. "Mbetje të rrezikshme" janë mbetjet që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
10. "Vend depozitimi" është sipërfaqja e rezervuar për depozitimin e mbetjeve minerare në gjendje të ngurtë ose të lëngshme, përfshirë deponitë e hirit, ku pjesë e kësaj sipërfaqeje është zakonisht ndërtimi i një dige ose një ndërtim tjetër i pjesshëm që shërben për mbajtjen, kapjen, kufizimin ose për një rol tjetër mbështetës;
11. "Vend i braktisur i depozitimit" është vendi i depozitimit, operatori i tij origjinal ose pasardhësi ligjor i të cilit nuk ekziston ose nuk njihet;
12. "Leje e menaxhimit të mbetjeve minerare" është akti administrativ, i dhënë në përputhje me këtë ligj, për të kryer veprimtarinë e menaxhimit të mbetjeve minerare, të krijuara nga aktiviteti minerar. Në kuptimin e këtij ligji, në vazhdim do të përdoret termi leja.
13. "Integritet strukturor i objektit të mbetjeve" është aftësia e objektit të mbetjeve dhe e strukturave përbërëse të tij për të siguruar që mbetjet të ngelen brenda kufijve të objektit, në përputhje me projektin dhe funksionin për të cilin ai është ndërtuar;
14. "Humbje e integritetit strukturor" është cënimi ose dështimi i integritetit strukturor të një objekti të mbetjeve, që përfshin të gjithë mekanizmat e mundshëm të dështimit të strukturave të objektit;
15. "Aksident i rëndë" është ngjarje e shkaktuar nga veprimtaria e kontrolluar, e karakterizuar nga humbje e menjëhershme e kontrollit, që çon në një rrezik serioz për shëndetin e njeriut ose mjedisin;
16. "Teknikat më të mira të disponueshme (TMD)" është stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të përcaktuar vlera kufi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundshme, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi.

17. “Infiltrim” është uji që kalon nëpër mbetjet minerare ose nëpër pjesën e jashtme të vendit të depozitimit;
18. “Rehabilitim progresiv” është rehabilitimi i sipërfaqeve të territorit të prekur nga veprimtaritë minerare, i kryer në mënyrë graduale gjatë fazës së operimit të objektit të mbetjeve minerare, në ato pjesë ku veprimtaria ka përfunduar dhe rehabilitimi është teknikisht i mundur;
19. “Rehabilitim përfundimtar” është rehabilitimi i territorit të prekur nga objekti i mbetjeve minerare, i kryer pas përfundimit të operimit dhe në kuadër të mbylljes së objektit, me qëllim rikthimin e territorit në një gjendje të kënaqshme nga pikëpamja mjedisore dhe të përshtatshme për përdorimin e tij të mëtejshëm.
20. “Struktura përgjegjëse” struktura në varësi të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare, e cila ushtron funksionet e monitorimit dhe inspektimit në fushën e menaxhimit të mbetjeve minerare.
21. “Garancia financiare” është vlera monetare që depozitohet, në formën e një garancie bankare në favor të shtetit, në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, ose në një bankë të huaj, që përdoret për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit dhe rikultivimin e zonës, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
22. “Person kompetent” është personi fizik që zotëron kualifikimet profesionale, përvojën dhe kompetencën teknike për projektimin, monitorimin, kontrollin ose vlerësimin e sigurisë së objekteve të mbetjeve minerare, sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
23. “Përpunimi i mineraleve” është procesi fizik, mekanik, biologjik, termik, kimik ose kombinimi i proceseve të kryera në mineral, i cili përfshin edhe punimet në shfrytëzimin sipërfaqësor, me qëllim nxjerrjen e mineralit. Ai gjithashtu përfshin ndryshimin e madhësisë, klasifikimin, ndarjen, shpëlarjen, si dhe ripërpunimin e mbetjeve të hedhura më parë, por duke përjashtuar shkrirjen, proceset e prodhimit termik dhe proceset metalurgjike;
24. “Lëng shplarës” është çdo lëng që përshkon nëpër mbetjen e depozituar dhe që del nga ose gjendet brenda një objekti mbetjesh, përfshirë ujërat e ndotura të kullimit, që mund të ndikojnë negativisht në mjedis nëse nuk trajtohen në mënyrë të përshtatshme;
25. “Digë” është struktura inxhinierike e projektuar për mbajtjen ose izolimin e ujit dhe/ose mbetjeve brenda një pellgu.
26. “Pellg” është objekti natyror, ose artificial për asgjësimin e mbetjeve me granulometri të imët, zakonisht sterilesh, së bashku me sasi të ndryshme uji të lirë, që rezultojnë nga përpunimi i mineraleve dhe nga pastrimi dhe riciklimi i ujërave të procesit
27. “Stoqet” janë strukturat inxhinierike për depozitimin e mbetjeve solide të veprimtarisë minerare mbi sipërfaqen e tokës.
28. “Tokë e pandotur” është shtresa e sipërme e tokës që hiqet gjatë aktivitetit minerar të shfrytëzimit dhe që nuk konsiderohet e ndotur, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe tokës.
29. “Vendburim minerali” ose “mineral” është një depozitë e një substance organike ose inorganike, që krijohet natyrshëm në koren e tokës, si: lëndët djegëse energjetike, mineralet metalore, industriale dhe materialet, duke përjashtuar ujin;
30. “Industria nxjerrëse” është tërësia institucioneve dhe ndërmarrjeve të përfshira në nxjerrjen sipërfaqësore ose nëntokësore të mineraleve për qëllime tregtare, duke përfshirë nxjerrjen dhe trajtimin e materialit të nxjerrë;

31. “Cianur i disocieshëm në acid të dobët” nënkupton cianurin dhe përbërjet e cianurit që disociohen në prani të një acidi të dobët në një vlerë të përcaktuar të pH-së.
32. “Kërkim zbulimi” është kryerja e operacioneve dhe e punimeve të nevojshme për kërkimin dhe zbulimin e mineraleve mbi sipërfaqen e tokës, për nxjerrjen dhe për lëvizjen e kampioneve minerare nga toka në sasi, për analiza, jo për tregti.
33. “Trup pritës i ujërave” është çdo ujë sipërfaqësor, ujë nëntokësor, ujë kalimtar ose ujë bregdetar në të cilin mund të shkarkohen ose të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi mbetjet minerare ose rrjedhjet që burojnë prej tyre.
34. “Publiku” nënkupton një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, si dhe shoqatat, organizatat ose grupet e tyre, të krijuara dhe që veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
35. “Publiku i interesuar” është publiku i prekur ose që mund të preket nga një vendimmarrje me ndikim në mjedis, ose që ka interes në këtë vendimmarrje. Organizatat jofitimprurëse të mbrojtjes së mjedisit, të krijuara dhe që veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi, konsiderohen si palë me interes në procesin e vendimmarrjes mjedisore.
36. “Autoriteti kompetent”është autoriteti i përcaktuar si përgjegjës për kryerjen e procesit të VNM-së, sipas legjislacionit mjedisor ne fuqi.

Neni 4
Parime të përgjithshme

1. Menaxhimi i mbetjeve minerare kryhet duke respektuar:
   a) parimin e parandalimit, sipas të cilit parandalohet ose pakësohet sa më shumë krijimi i mbetjeve minerare;
   b) parimin e “ndotësi paguan”, sipas të cilit kostot e menaxhimit të mbetjeve minerare mbulohen nga operatori;
   c) parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, duke garantuar që veprimtaritë minerare të mos cënojnë aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre;
   ç) parimin e afërsisë, sipas të cilit mbetjet minerare menaxhohen në vendin ku krijohen, kur kjo është e mundur dhe e përshtatshme për mjedisin;
   d) parimin e sigurisë, duke garantuar që objektet e mbetjeve minerare të projektohen, ndërtohen, operohen dhe mbyllen në mënyrë të sigurt;
   dh) parimin e transparencës, duke siguruar informimin e publikut për veprimtaritë dhe rreziqet e lidhura me objektet e mbetjeve minerare;
   e) pjesëmarrjen e njësive vendore gjatë procesit të të konsultimit publik.
2. Menaxhimi i mbetjeve minerare kryhet sipas kritereve të efikasitetit, eficiencës, leverdisë ekonomike, transparencës dhe fizibilitetit.

Neni 5
Kategoritë dhe kriteret e klasifikimit

1. Objektet e mbetjeve minerare klasifikohen në:
   a) Kategorinë A – objektet me rrezik të lartë të aksidenteve të rënda;
   b) Kategorinë B – objektet që nuk plotësojnë kushtet për klasifikim në Kategorinë A.

2. Objekti i mbetjeve minerare klasifikohet në kategorinë A nëse, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe, kur është e zbatueshme, në vlerësimin e kryer nga një person i autorizuar ose institucion i autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi, rezulton se një dështim teknik ose funksionim i gabuar mund të shkaktojë një aksident të rëndë. Në klasifikim merren në konsideratë madhësia dhe vendndodhja e objektit të mbetjeve minerare, ndikimi i mundshëm në mjedis, si dhe sasia e mbetjeve minerare të rrezikshme ose vëllimi i substancave dhe përbërjeve kimike të rrezikshme të përmbajtura në to, sipas kritereve të përcaktuara në aktet nënligjore.
3. Kërkesa për klasifikimin e objektit të mbetjeve minerare duhet të përmbajë:
   a) karakteristikat, sasinë dhe vetitë fiziko-mekanike dhe kimike të mbetjeve minerare që do të depozitohen, sipas Aneksin II, të këtij ligji;
   b) klasifikimin e mbetjeve minerare sipas legjislacionit në fuqi;
   c) përshkrimin e substancave dhe preparateve kimike që përdoren gjatë përpunimit të mineraleve;
   ç) përshkrimin e mënyrës së depozitimit të mbetjeve minerare;
   d) përshkrimin e sistemit të transportit të mbetjeve minerare në objektin e mbetjeve minerare.
4. Kur ndryshimet në përbërjen ose karakteristikat e mbetjeve minerare mund të ndikojnë në klasifikimin e objektit të mbetjeve minerare, operatori është i detyruar të njoftojë strukturën përgjegjëse dhe të kërkojë rishikimin e klasifikimit.
5. Klasifikimi kryhet përpara dhënies së lejes që përfshin krijimin ose ndryshimin e një objekti mbetjesh, dhe rishikohet:
   a) kur kushtet e lejes ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme;
   b) kur kushtet operacionale të objektit ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme;
   c) në çdo rast, jo më vonë se në përfundim të fazës operacionale të objektit.
6. Procedura dhe kriteret për klasifikimin e objekteve të mbetjeve minerare në kategorinë A ose B, metodologjia për vlerësimin e karakteristikave të mbetjeve minerare, përcaktohen me propozim të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave

KREU II
MENAXHIMI I MBETJEVE MINERARE

Neni 6
Kërkesat e përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve minerare

1. Gjatë menaxhimit të mbetjeve minerare operatori është i detyruar:
   a) të mos rrezikojë jetën dhe shëndetin e banorëve të zonës;
   b) të mos përdorë procese dhe metoda që dëmtojnë mjedisin, veçanërisht sa i përket cilësisë së ujit, ajrit ose tokës;
   c) të mos shkaktojë shqetësim nga zhurma ose era mbi masën e përcaktuar nga akte ligjore të tjera;
   ç) të mos shkaktojë ndikim negativ në peizazh, bimë, kafshë ose në zona të veçanta të mbrojtura, rezervat dhe zonat e monumenteve kulturore, ose zona të mbrojtura të përcaktuar sipas akteve ligjore të tjera.

2. Operatori është i detyruar të marrë masa për të parandaluar efektet negative në shëndetin e njeriut dhe mjedisin e shkaktuara nga menaxhimi i mbetjeve minerare ose për kufizimin maksimal të mundshëm të tij, ndikimeve gjatë operimit të vendit të depozitimit dhe pas përfundimit të tij, përfshirë parandalimin e aksidenteve të rënda të shkaktuara nga operimi i këtij objekti dhe kufizimin e pasojave negative të një aksidenti të mundshëm të rëndë në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.
3. Masat ekonomikisht të zbatueshme sipas pikës 2 bazohen ndër të tjera në teknikat më të mira të disponueshme, pa u përcaktuar se cilën teknikë ose teknologji, duke marrë parasysh karakteristikat teknike të vendit të depozitimit, vendndodhjen gjeografike të tij dhe kushtet lokale të mjedisit, është e domosdoshme të përdoret.
4. Ndalohet depozitimi i mbetjeve minerare në një vend tjetër përveç atij të përcaktuar nga plani për menaxhimin e mbetjeve minerare.
5. Operatori është i detyruar të mbajë dokumentacion operativ dhe regjistra të të gjitha veprimtarive të lidhura me menaxhimin e mbetjeve minerare, përfshirë regjistrat e depozitimit të mbetjeve minerare sipas pikës 6 të nenit 13.
6. Operatori është i detyruar ta rrethojë hapësirën e objektit të depozitimit dhe të sigurojë parandalimin e hyrjes së personave të paautorizuar. Kjo detyrë përfundon njëkohësisht me përfundimin e punimeve të rehabilitimit dhe rikultivimit.
7. Operatori është i detyruar të mos lejojë dëmtimin e pajisjeve dhe vendeve të depozitimit.
8. Operatori është i detyruar të mos depozitojë në hapësirën e përcaktuar të depozitimit mbetje ose objekte të tjera, përveç atyre që janë përcaktuar në plan.

Neni 7
Plani i menaxhimit të mbetjeve minerare

1. Operatori duhet të hartojë planin e menaxhimit të mbetjeve minerare, me qëllim minimizimin e krijimit të mbetjeve minerare, përpunimin, shfrytëzimin dhe asgjësimin e tyre.
2. Plani duhet të përmbajë kushtet për:
   a) parandalimin e krijimit të mbetjeve minerare dhe dëmtimit ose kufizimin të tyre, duke marrë parasysh veçanërisht:
      i. ndikimin e metodës së përdorur për nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve në krijimin e mbetjeve minerare dhe mënyrën e menaxhimit të tyre, që në fazën e projektimit të nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve,
      ii. ndryshimet që mund t'i ndodhin mbetjeve minerare si rezultat i rritjes së sipërfaqes aktive të tyre të ekspozuar ndaj kushteve në sipërfaqe,
      iii. mundësinë e mbushjes së hapësirave të nxjerra me mbetje minerare pas përfundimit të nxjerrjes së mineraleve, nëse kjo është teknike dhe ekonomikisht e zbatueshme dhe e mirë për mjedisin, në përputhje me kuadrin ligjor ne fuqi,
      iv. mundësinë e rikthimit të shtresës të kulturave bujqësore të tokës, e cila është mjedis vegjetal i bimësisë, pas përfundimit të operimit të vendit të depozitimit, ose nëse kjo nuk është praktikisht e mundur, përdorimi i saj i ri në një vend tjetër,
      v. kufizimin e përdorimit të substancave dhe përbërjeve të rrezikshme gjatë përpunimit të mineraleve.

b) sigurimin e depozitimit të sigurt të mbetjeve minerare duke marrë parasysh që në fazën e projektimit mënyrën e menaxhimit të tillë mbetje gjatë operimit të vendit të depozitimit dhe garantimin e një gjendjeje të sigurt pas përfundimit të operimit, dhe kjo përmes zgjedhjes së një projekti i cili:

i. parashikon kërkesa minimale ose, nëse është e mundur, asnjë kërkesë për monitorimin, kontrollin dhe menaxhimin e vendit të depozitimit të mbyllur,

ii. parandalon efektet e tij afatgjata të pafavorshme përreth vendit të depozitimit, veçanërisht ato që ndodhin për shkak të transferimit të substancave ndotëse nga vendi i depozitimit nëpërmjet ajrit ose ujit ose të paktën i minimizon këto efekte,

iii. siguron qëndrueshmërinë gjeoteknike afatgjatë të vendit të depozitimit.

c) nxitjen e shfrytëzimit të mbetjeve minerare, nëse kjo është e mirë për mjedisin dhe në përputhje me këtë ligj,

ç) vendndodhjen e vendit të depozitimit përfshirë edhe ato alternative,

d) rehabilitimin dhe rikultivimin e territorit të prekur nga operimi i vendit të depozitimit,

dh) depozitimin e mbetjeve minerare nga perspektiva e llojit dhe vetive të tyre.

3. Operatori duhet të rishikojë planin çdo 5 vjet. Ndryshimet e planit i bën pa vonesë të justifikueshme gjithmonë kur ndodhin ndryshime në përbërjen e mbetjeve minerare të depozituara që do të çonin në ndryshimin e klasifikimit të mbetjeve minerare ose të kategorisë së vendit të depozitimit, ose në ndryshime të tilla në operimin e vendit të depozitimit që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm negativ në shëndetin e njeriut ose në mjedis. Për ndryshimet e bëra në plan, operatori duhet të marrë miratim nga struktura përgjegjëse.
4. Forma dhe permbajtja e planit te menaxhimit te mbetjeve minerare, llojet e shtojcave të kërkesës për miratimin e planit dhe kërkesat për përmbajtjen e këtyre shtojcave përcaktohen udhëzim të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare.

Neni 8
Leja për menaxhimin e mbetjeve minerare

1. Leja për menaxhimin e mbetjeve minerare, miratohet nga ministri, dhe lëshohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në përputhje me ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Leja për menaxhimin e mbetjeve minerare, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihet në kategorinë IV.1 të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". Për dhënien e kësaj leje nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.
3. Për këtë leje, vendimi përfundimtar i miratimit njoftohet dhe hyn në fuqi në datën e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Kërkuesi i lejes duhet të paraqesë dokumentin e garancisë financiare, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të miratimit të lejes.
5. Procedura, kushtet, dokumentacioni, afatet, si dhe struktura përgjegjëse për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës për lejen, përcaktohen me propozim të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9
Ndryshimi i kushteve te lejes

1. Operatori kërkon ndryshimin e lejes kur:
   a) ka ndryshime në përbërjen e mbetjeve ose operimin;
   b) monitorimi tregon ndryshime që ndikojnë në sigurinë.
2. Struktura përgjegjëse mund të fillojë kryesisht procedurën për ndryshimin e kushteve te lejes edhe kur operatori nuk ka kërkuar ndryshimin e detyrueshëm.
3. Procedura e ndryshimit ndjek të njëjtat hapa si procedurat e marrjes se lejes fillestare.

Neni 10
Transferimi i të drejtave të lejes

1. Lejet e menaxhimit të mbetjeve minerare janë të transferueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ministri. Çdo transferim i kryer pa miratimin paraprak është i pavlefshëm.
2. Miratimi ose refuzimi i ministrit, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet brenda një afati prej 60 ditësh kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës së transferimit nga operatori i lejes.
3. Ndërtimet dhe instalimet e tjera, që mbështesin operacionet kryesore, vlerësohen si veprimtari ndihmëse të pandashme të së drejtës së lejes së menaxhimit të mbetjeve dhe transferohen bashkë me të.
4. Kriteret dhe rregullat e transferimit të lejes të menaxhimit të mbetjeve minerare, përcaktohen me propozim të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11
Përgjegjësitë e transferimit të lejes

1. Transferuesi i lejes është përgjegjës për të gjitha detyrimet ndaj shtetit deri në çastin e transferimit.
2. Përfituesi i lejes është përgjegjës për të gjitha detyrimet ndaj shtetit.
3. Në rast të transferimit të lejes, transferuesi siguron dorëzimin e plotë, te zotëruesi i ri i lejes, të dokumentacionit, regjistrave dhe informacionit të përditësuar, që lidhet me objektin e mbetjeve minerare.

KREU III
INFORMIMI DHE KONSULTIMI

Neni 12
Pjesëmarrja e publikut dhe konsultimi

1. Struktura përgjegjëse siguron përmes portalit të administratës publike, si dhe takimeve me publikun e interesuar, informimin për objektet e Kategorisë A, në kuadër të procedurës së lejimit, për:
   a) kërkesën për leje;

b) dokumentet bazë për vendimin që do të lëshohet;
c) faktin se vendimi për lejimin i nënshtrohet konsultimit midis shteteve ndërkufitare;
ç) të dhënat e organeve nga të cilat mund të merret informacion dhe të cilave mund t'u parashtrohen vërejtje ose pyetje, si dhe afatet për dorëzimin e vërejtjeve dhe pyetjeve;
d) të dhënat që lidhen me propozimin për ndryshim të lejes ose kushteve të lejes;
dh) propozimin e vendimit për lejimin e operimit të vendit të depozitimit dhe ndryshimet në lejen e operimit të vendit të depozitimit.

2. Publiku ka të drejtë të paraqesë vërejtjet dhe sugjerimet brenda 30 ditëve, në portalin e strukturës përgjegjëse, të cilat merren parasysh në vendimmarrje.
3. Informacioni për operatorët që janë të pajisur me leje për menaxhimin e mbetjeve minerare të Kategorisë A, sigurohet përmes portalit të strukturës përgjegjëse, përfshin:
a) emrin e operatorit të lejes dhe adresën e objektit të mbetjeve;
b) identifikimin, sipas pozicionit të mbajtur, të personit që jep informacionin;
c) konfirmimin që objekti i mbetjeve është ndërtuar dhe operon sipas kuadrit ligjor;
ç) një shpjegim të qartë të veprimtarisë së ushtruar;
d) emrat dhe klasifikimin e rrezikut të substancave që mund të shkaktojnë aksident të rëndë;
dh) informacion të përgjithshëm mbi natyrën e rrezikut dhe efektet e mundshme;
e) informacion mbi mënyrën e paralajmërimit në rast aksidenti;
ë) informacion mbi veprimet që popullsia duhet të ndërmarrë në rast aksidenti;
f) konfirmimin që operatori i lejes është i detyruar të marrë masat e duhura;
g) referencë ndaj planit të jashtëm të emergjencës;
gj) detaje mbi vendin ku mund të merret informacion shtesë.
4. Informacioni rishikohet çdo 2 vjet.
5. Struktura përgjegjëse mban, përditëson dhe publikon inventarin e plotë të objekteve të mbetjeve minerare, të mbyllura dhe aktive.

KREU IV

NDËRTIMI, OPERIMI, MBYLLJA DHE PASMBYLLJA E OBJEKTEVE TË MBETJEVE MINERARE

Neni 13

Kërkesat për ndërtimin dhe menaxhimin e objekteve të mbetjeve minerare

1. Operatori projekton, ndërton, operon, mirëmban, mbyll dhe monitoron objektin e mbetjeve minerare në mënyrë që të garantohet stabiliteti fizik dhe kimik i tij, të parandalohet ndotja e mjedisit dhe të mbrohet shëndeti i njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës së objektit.
2. Gjatë projektimit dhe operimit të objektit të mbetjeve minerare, operatori merr në konsideratë në veçanti:
a) karakteristikat gjeologjike, hidrologjike, hidrogjeologjike, sizmike dhe gjeoteknike të zonës;
b) vendndodhjen dhe ndikimin e mundshëm të objektit mbi mjedisin dhe popullsinë;
c) karakteristikat fizike dhe kimike të mbetjeve minerare;

ç) parandalimin e ndotjes së tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe ajrit;
d) kufizimin e erozionit dhe të përhapjes së pluhurit;
dh) përdorimin e teknikave më të mira të disponueshme.

3. Operatori është i detyruar të sigurojë që objekti i mbetjeve minerare të ndërtohet dhe të operohet në mënyrë që të ruhet integriteti strukturor dhe të parandalohet çdo rrezik për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.
4. Operatori harton dhe zbaton procedura për monitorimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen periodike të objektit të mbetjeve minerare gjatë operimit dhe pas mbylljes së tij.
5. Operatori njofton strukturën përgjegjëse, pa vonesë dhe në çdo rast jo më vonë se 48 orë, për çdo ngjarje që mund të cënojë stabilitetin e objektit të mbetjeve minerare, si dhe për çdo ndikim të rëndësishëm negativ në mjedis të evidentuar gjatë monitorimit dhe kontrollit të objektit. Operatori përballon kostot e masave korrigjuese që duhet të ndërmerren.
6. Operatori mban dokumentacionin teknik, regjistrat e monitorimit dhe rezultatet e kontrolleve gjatë gjithë periudhës së operimit dhe pas mbylljes, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
7. Operatori merr masat e nevojshme për të parandaluar hyrjen e personave të pa autorizuar në objektin e mbetjeve minerare dhe për të garantuar sigurinë e tij gjatë gjithë periudhës së operimit.

Neni 14
Mbyllja e objektit të mbetjeve minerare

1. Mbyllja e objektit të mbetjeve minerare kryhet në përputhje me kushtet e lejes, planin e menaxhimit të mbetjeve minerare dhe planin e rehabilitimit.
2. Operatori paraqet pranë strukturës përgjegjëse kërkesën për miratimin e mbylljes së objektit të mbetjeve minerare, të shoqëruar me dokumentacionin teknik që provon përmbushjen e kushteve të përcaktuara në leje.
3. Ministri miraton mbylljen e objektit të mbetjeve minerare vetëm pasi struktura përgjegjëse konstaton nëpërmjet verifikimeve dhe inspektimeve të nevojshme, dhe raporton, se janë përmbushur kushtet e këtij ligji dhe të lejes.
4. Miratimi i mbylljes së objektit nuk e çliron operatorin nga detyrimet për monitorimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e objektit gjatë periudhës së pasmbylljes.
5. Kushtet, procedurat dhe dokumentacioni për miratimin e mbylljes së objektit të mbetjeve minerare përcaktohen me propozim të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave

Neni 15
Detyrimet gjatë periudhës së pas mbylljes

1. Pas miratimit të mbylljes së objektit të mbetjeve minerare, operatori është përgjegjës për monitorimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e objektit për aq kohë sa ai mund të paraqesë rrezik për shëndetin e njerëzve ose mjedisin, për kategorinë A – 10 vite, për kategorinë B – 5 vite.

2. Operatori monitoron në mënyrë periodike stabilitetin fizik dhe kimik të objektit të mbetjeve minerare, si dhe ndikimin e tij mbi tokën, ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe mjedisin.
3. Nëse gjatë monitorimit konstatohen zhvillime që mund të ndikojnë në sigurinë e objektit ose të shkaktojnë ndotje të mjedisit, operatori merr menjëherë masat korrigjuese, zbaton planin e emergjencës dhe njofton strukturën përgjegjëse. Operatori përballon kostot e masave korrigjuese që duhet të ndërmerren.
4. Struktura përgjegjëse kryen inspektime dhe verifikime periodike gjatë periudhës së pasmbylljes dhe mund të kërkojë marrjen e masave shtesë, kur kjo është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit.
5. Detyrimet e operatorit gjatë periudhës së pasmbylljes përfundojnë vetëm me vendim të strukturës përgjegjëse, pasi kjo e fundit konstaton se objekti i mbetjeve minerare nuk paraqet më rrezik për shëndetin e njerëzve ose mjedisin.

KREU V
PARANDALIMI I AKSIDENTEVE TË RËNDA

Neni 16
Parandalimi i aksidenteve të rënda dhe informimi

1. Ky nen zbatohet për objektet e mbetjeve minerare të kategorisë A.
2. Operatori merr të gjitha masat e nevojshme për identifikimin e rreziqeve të aksidenteve të rënda dhe siguron që kërkesat për parandalimin e tyre të integrohen në projektimin, ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen, mbylljen dhe periudhën pas mbylljes së objektit të mbetjeve minerare, me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe kufizimin e pasojave të tyre për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.
3. Përpara fillimit të veprimtarisë, operatori harton politikën për parandalimin e aksidenteve të rënda, zbaton sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe harton planin e brendshëm të emergjencës. Operatori cakton gjithashtu personin përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin periodik të politikës për parandalimin e aksidenteve të rënda. Politika për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe sistemi i menaxhimit të sigurisë hartohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Aneksin I, që i bashkëlidhet këtij ligji.
4. Struktura përgjegjëse harton planin e jashtëm të emergjencës, bazuar në informacionin e paraqitur nga operatori si pjesë e dokumentacionit për pajisjen me leje.
5. Planet e emergjencës kanë për qëllim kufizimin dhe kontrollin e aksidenteve të rënda, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit, informimin e publikut dhe autoriteteve kompetente, si dhe rehabilitimin dhe rivendosjen e mjedisit pas një aksidenti të rëndë.
6. Në rast të një aksidenti të rëndë, operatori njofton menjëherë strukturën përgjegjëse dhe i vë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm për kufizimin e pasojave dhe vlerësimin e dëmit të shkaktuar.
7. Publiku informohet dhe përfshihet në hartimin ose rishikimin e planit të jashtëm të emergjencës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Informacioni mbi masat e sigurisë dhe veprimet që duhet të ndërmerren në rast aksidenti vihet në dispozicion të publikut pa pagesë dhe rishikohet periodikisht, sipas kërkesave të përcaktuara në Aneksin I të këtij ligji.

KREU VI
MBROJTJA E MJEDISIT

Neni 17
Mbrojtja e ujërave, tokës dhe mjedisit

1. Operatori merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ose, kur kjo nuk është e mundur, për të minimizuar ndikimet negative të objektit të mbetjeve minerare mbi tokën, ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe mjedisin.
2. Projektimi, ndërtimi, operimi, mbyllja dhe pasmbyllja e objektit të mbetjeve minerare duhet të sigurojnë:
   a) parandalimin ose minimizimin e formimit dhe përhapjes së infiltrimeve;
   b) mbledhjen, kontrollin dhe trajtimin e infiltrimeve dhe ujërave të ndotura, kur kjo kërkohet sipas karakteristikave të objektit dhe legjislacionit në fuqi;
   c) parandalimin e ndotjes së tokës dhe ujërave sipërfaqësore e nëntokësore;
   ç) kontrollin e bilancit të ujit në objektin e mbetjeve minerare, kur kjo kërkohet nga natyra e veprimtarisë.
3. Kur, bazuar në një vlerësim të rrezikut mjedisor dhe duke marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e ujërave, struktura përgjegjëse konstaton se mbledhja dhe trajtimi i infiltrimeve nuk është i nevojshëm, ose objekti i mbetjeve nuk paraqet rrezik për tokën, ujërat nëntokësore ose ujërat sipërfaqësore, kërkesat e përcaktuara në shkronjat a) dhe b) të pikës 2 të këtij neni mund të reduktohen ose të mos zbatohen.
4. Hedhja e mbetjeve nxjerrëse, në formë të ngurtë, llumi ose të lëngshme, në çdo trup ujor që nuk është ndërtuar posaçërisht për depozitimin e këtyre mbetjeve, lejohet vetëm nëse operatori përmbush kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e ujërave dhe mjedisit.
5. Operatori merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ose, kur kjo nuk është e mundur, për të minimizuar emetimet e pluhurit dhe gazeve nga objekti i mbetjeve minerare, në përputhje me kërkesat e lejes dhe legjislacionit në fuqi.
6. Operatori monitoron periodikisht cilësinë e ujërave dhe funksionimin e sistemeve të mbrojtjes së mjedisit, sipas kushteve të lejes dhe planit të monitorimit.
7. Në rastet kur mbetjet nxjerrëse vendosen në zgavra gërmimi, të krijuara nga veprimtaritë minerare sipërfaqësore ose nëntokësore, të cilat do të përmbyten pas mbylljes së veprimtarisë, operatori merr masat e nevojshme për të parandaluar ose minimizuar përkeqësimin e gjendjes së ujërave dhe ndotjen e tokës, në përputhje me kërkesat e pikave 1 dhe 3 të këtij neni.
Operatori i paraqet autoritetit kompetent të gjithë informacionin e nevojshëm për të garantuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e ujërave.
8. Në rastin e pellgjeve të sterileve që përmbajnë cianur, operatori siguron që përqendrimi i cianurit të disociueshëm në acid të dobët të reduktohet në nivelin më të ulët të mundshëm duke përdorur teknikat më të mira të disponueshme. Përqendrimi i cianurit të disociueshëm në acid të dobët në

pikën e shkarkimit të sterileve nga impianti i përpunimit në pellgun e sterileve nuk duhet të tejkalojë vlerën 10 mg/kg (10 ppm).
9. Në rast se konstatohet ndotje ose rrezik i afërt për ndotje të tokës apo ujërave, operatori merr menjëherë masat korrigjuese dhe njofton strukturën përgjegjëse dhe autoritetet përgjegjëse për mjedisin.
10. Kërkesat teknike për projektimin e sistemeve të mbrojtjes, monitorimin e ujërave, kontrollin e infiltrimeve dhe bilancin e ujit përcaktohen me propozim të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18
Efektet ndërkufitare

1. Kur autoriteti kompetent vlerëson se, funksionimi i një objekti depozitimi të mbetjeve minerare mund të ketë efekte të rëndësishme negative në mjedisin ose shëndetin e njerëzve në territorin e një shteti tjetër, ose kur një shtet tjetër që mund të preket ndjeshëm nga këto efekte paraqet kërkesë për informacion, autoriteti kompetent bashkëpunon me autoritetet kompetente të shtetit tjetër të prekur.
2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, autoriteti kompetent:
   a) i siguron autoriteteve kompetente të shtetit tjetër të prekur informacionin përkatës lidhur me kërkesën për miratim, ndryshimin ose funksionimin e objektit të depozitimit të mbetjeve minerare,
   b) siguron shkëmbimin e informacionit dhe konsultimin ndërmjet autoriteteve kompetente të vendeve të prekura, me qëllim vlerësimin e ndikimeve të mundshme ndërkufitare dhe përcaktimin e masave të nevojshme parandaluese ose korrigjuese.
3. Autoriteti kompetent siguron që publiku i shtetit tjetër të prekur të ketë mundësi të marrë pjesë në procedurat përkatëse të vendimmarrjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.
4. Dispozitat e këtij neni zbatohen në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi për bashkëpunimin ndërkufitar në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Neni 19
Mbushja e hapësirave të krijuara nga nxjerrja e mineraleve

1. Operatori, në rastet kur përdor hapësirat e krijuara nga aktivitetet e kërkimit, nxjerrjes ose përpunimit të mineraleve për depozitimin e mbetjeve minerare, duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar:
   a) stabilitetin e këtyre hapësirave dhe të mbetjeve minerare të depozituara në to;
   b) parandalimin e ndotjes së tokës, ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore;
   c) mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit gjatë gjithë periudhës së funksionimit dhe pas mbylljes së aktivitetit.
2. Përdorimi i hapësirave të krijuara nga aktivitetet nxjerrëse për depozitimin e mbetjeve minerare lejohet vetëm nëse është parashikuar në planin e menaxhimit të mbetjeve minerare dhe është

miratuar nga struktura përgjegjëse, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

3. Operatori harton dhe zbaton masa për monitorimin dhe kontrollin e qëndrueshmërisë strukturore, si dhe për parandalimin e ndikimeve negative në mjedis, gjatë gjithë periudhës së funksionimit dhe pas mbylljes së hapësirave të mbushura me mbetje minerare.
4. Kërkesat teknike, kriteret dhe procedurat për përdorimin e hapësirave të krijuara nga aktivitetet nxjerrëse për depozitimin e mbetjeve minerare, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare.

KREU VII
GARANCIA FINANCIARE DHE MBIKËQYRJA

Neni 20
Detyrimi për garancinë financiare

1. Operatori është i detyruar të vendosë garanci financiare përpara fillimit të ndërtimit ose operimit të objektit të mbetjeve minerare.
2. Garancia financiare ka për qëllim të sigurojë disponueshmërinë e fondeve të nevojshme për:
   a) rehabilitimin dhe rikultivimin e territorit të prekur;
   b) mbylljen e objektit të mbetjeve minerare;
   c) monitorimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin gjatë periudhës së pasmbylljes;
   ç) zbatimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit, në rast se operatori nuk përmbush detyrimet e tij.
3. Operatori nuk mund të fillojë veprimtarinë e menaxhimit të mbetjeve minerare pa paraqitur garancinë financiare, në përputhje me këtë ligj.
4. Kur Ministri miraton mbylljen e objektit të mbetjeve, në përputhje me pikën 3 të nenit 14 të këtij ligji, ai i lëshon operatorit një akt me shkrim për lirimin nga detyrimi i garancisë financiare, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përveç detyrimeve që vazhdojnë të zbatohen pas mbylljes, sipas përcaktimeve të nenit 15.

Neni 21
Përcaktimi i garancisë financiare

1. Vlera e garancisë financiare përcaktohet mbi bazën e:
   a) kategorisë dhe karakteristikave të objektit të mbetjeve minerare;
   b) natyrës, sasisë dhe rrezikshmërisë së mbetjeve minerare;
   c) kostove të rehabilitimit, rikultivimit, mbylljes dhe monitorimit pas mbylljes;
   ç) kostove të masave që mund të nevojiten për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve.
2. Garancia financiare duhet të jetë e mjaftueshme për të siguruar që të gjitha detyrimet e operatorit sipas këtij ligji mund të përmbushen në çdo kohë.
   Garancia financiare do të përditësohet çdo 2 vjet me çmimet e tregut dhe indeksimin sipas inflacionit.
3. Metodologjia për llogaritjen e garancisë financiare miratohet me udhëzim të Ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare.

Neni 22
Përditësimi i garancisë financiare

1. Operatori është i detyruar të përditësojë garancinë financiare, përveç parashikimit të pikës 2, neni 21, edhe në rastet kur:
   a) ndryshon plani i menaxhimit të mbetjeve minerare;
   b) ndryshon kategoria ose kapaciteti i objektit;
   c) ndryshojnë kostot e rehabilitimit, mbylljes ose monitorimit;
   ç) kërkohet nga struktura përgjegjëse, bazuar në rezultatet e monitorimit ose inspektimit.

2. Operatori duhet të paraqesë dokumentin e garancisë financiare, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e njoftimit të rivlerësimit të saj.

3. Struktura përgjegjëse verifikon periodikisht nëse garancia financiare mbetet e mjaftueshme për të mbuluar detyrimet e operatorit.

Neni 23
Përgjegjësia mjedisore

Operatori përgjigjet për dëmet e shkaktuara në mjedis si rezultat i menaxhimit të mbetjeve minerare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

KREU VIII
INSPEKTIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Neni 24

Inspektimi i objekteve të mbetjeve minerare

1. Struktura përgjegjëse kryen inspektime të objekteve të mbetjeve minerare përpara fillimit të depozitimit të mbetjeve minerare, më pas, gjatë fazës së operimit, mbylljes dhe pasmbylljes, çdo 6 muaj, si dhe inspektime të jashtëzakonshme për të verifikuar përputhshmërinë e objekteve të mbetjeve minerare me kërkesat e këtij ligji, të akteve nënligjore dhe të kushteve të lejes. Konstatimi i përputhshmërisë gjatë inspektimit nuk e çliron operatorin nga përgjegjësitë që rrjedhin nga kushtet e lejes.
2. Inspektimet kryhen gjatë ndërtimit, kolaudimit, operimit, mbylljes dhe periudhës së pasmbylljes së objektit të mbetjeve minerare.
3. Gjatë inspektimit, struktura përgjegjëse ka të drejtë:
   a) të hyjë në objektin e mbetjeve minerare;
   b) të kërkojë dokumentacionin teknik dhe operativ;
   c) të verifikojë rezultatet e monitorimit;

ç) të marrë mostra dhe të kryejë matje ose analiza;

d) të kërkojë marrjen e masave korrigjuese.

4. Operatori është i detyruar të mbajë regjistra të përditësuar për të gjitha veprimtaritë e menaxhimit të mbetjeve minerare dhe t'i vërë ato në dispozicion të strukturës përgjegjëse për inspektim.

5. Operatori është i detyruar të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse dhe të sigurojë akses në objekt, dokumentacion dhe informacion.

Neni 25

Raportimi

1. Operatori paraqet pranë strukturës përgjegjëse çdo 6 muaj kalendarikë, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas gjashtëmujorit përkatës kalendarik, një informacion mbi monitorimin e objektit të mbetjeve minerare.
2. Raportet përmbajnë të dhëna mbi:
   a) stabilitetin e objektit;
   b) cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, sipas rastit;
   c) funksionimin e sistemeve të mbrojtjes së mjedisit;
   ç) rezultatet e monitorimit;
   d) aksidentet, incidentet dhe masat korrigjuese të marra.
3. Forma dhe përmbajtja e raporteve mbi monitorimin e objektit të mbetjeve minerare përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare.
4. Struktura përgjegjëse mban dhe administron informacion periodik për monitorimin, incidentet, aksidentet dhe ngjarjet e raportuara nga operatorët sipas këtij ligji. Ky informacion vihet në dispozicion të autoriteteve kompetente dhe të publikut të interesuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit. Informacioni me natyrë të mirëfilltë tregtare, si informacioni që ka të bëjë me marrëdhëniet e biznesit, komponentët e kostove dhe volumin e rezervave minerare ekonomike, nuk bëhet publik.

KREU IX

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, PEZULLIMI DHE REVOKIMI

Neni 26

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
   a) kryerja e veprimtarive së menaxhimit të mbetjeve pa leje, me gjobë në shumën 2,000,000 (dy milionë) lekë për çdo shkelje;
   b) mosrespektimi i detyrimeve dhe kushteve që janë përcaktuar në leje, të lidhura me

mosrespektimin e planit të menaxhimit të mbetjeve minerare, me gjobë 500,000 (pesëqind mijë) lekë për çdo shkelje;

c) shkelja e dispozitave të pikave 6 dhe 7, të nenit 6, me gjobë 500,000 (pesëqind mijë) lekë për çdo shkelje;

ç) shkelja e dispozitave të pikave 5 dhe 8, të nenit 6, me gjobë 1,000,000 (një milion) lekë për çdo shkelje;

d) shkelja e dispozitës të pikës 1, të nenit 25, me gjobë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo shkelje;

2. Sanksionet e parashikuara në këtë nen, vendosen nga struktura përgjegjëse, nëse nga data e kryerjes së shkeljes nuk ka kaluar një periudhë më e madhe se 2 vite kalendarike.
3. Shkeljet konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë, duke përshkruar shkeljen. Formati i aktit të konstatimit miratohet me urdhër të ministrit.
4. Sanksionet vendosen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e konstatimit të shkeljes dhe njohjes së shkelësit dhe i njoftohen me shkrim shkelësit.
5. Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit pranë ministrisë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit. Ministri ngre njësinë e ankimit, e cila shqyrton ankimin administrativ, administron dhe shqyrton provat e njofton vendimin brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit. Ky afat mund të shtyhet nga ministria deri në 10 ditë kalendarike, në rast se çmohet kryerja e verifikimeve në vendin ku ushtrohet veprimtaria minerare dhe me kusht që të njoftohet subjekti, ndaj të cilit është vendosur masa administrative. Kundër vendimit të strukturës përgjegjëse dhe vendimit të njësisë së ankimit mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi. Njësia e ankimit ngrihet dhe funksionon sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.
6. Gjoba paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për dhënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi.
7. Kryerja për herë të dytë nga i njëjti operator i shkeljeve të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes deri në plotësimin e detyrimit.

Neni 27

Pezullimi i lejes

1. Leja pezullohet kur:

a) shkelet dispozita e parashikuar në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji;

b) shkelet dispozita e parashikuar në nenin 6, pika 2, të këtij ligji;

2. Shkeljet që bëhen shkak për pezullim konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë me përshkrimin e arsyes së pezullimit.

3. Pezullimi i lejes nga struktura e përgjegjëse shoqërohet me lënien e detyrave për korrigjimin e shkeljeve. Detyrat zbatohen nga operatori i lejes brenda afatit të pezullimit, përveçse kur përcaktohet ndryshe në aktin e pezullimit. Struktura përgjegjëse verifikon korrigjimin e shkeljeve

jo më vonë se 10 ditë nga data e lënë për korrigjimin e shkeljeve. Kur ky afat nuk respektohet, shkeljet quhen të korrigjuara dhe subjekti mund të rifillojë nga puna.
4.Vendimi i pezullimit merret nga titullari i strukturës përgjegjëse jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga konstatimi i shkakut të pezullimit dhe njohjes së shkeljes dhe i njoftohen me shkrim operatorit.
5. Subjekti, ndaj të cilit merret masa e pezullimit, ka të drejtën e ankimit pranë ministrit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit. Ministri ngre njësinë e ankimit, e cila shqyrton ankimin administrativ, administron e shqyrton provat dhe njofton vendimin brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit. Ky afat mund të shtyhet nga ministria deri në 10 ditë kalendarike në rast se çmohet kryerja e verifikimeve në vendin ku ushtrohet veprimtaria dhe me kusht që të njoftohet subjekti, ndaj të cilit është vendosur masa administrative. Kundër vendimit të strukturës përgjegjëse dhe vendimit të njësisë së ankimit mund të bëhet ankim në gjykatën administrative sipas legjislacionit në fuqi. Njësia e ankimit ngrihet dhe funksionon sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare.

Neni 28
Revokimi i lejes

1. Leja revokohet kur:
   a) pas dhënies së saj, konstatohet se në dokumentacionin e paraqitur për lejen, ka të dhëna të rreme apo se operatori nuk përmbush kushtet e lejimit;
   b) operatori i lejes pezullon ose ndërpret veprimtarinë e menaxhimit të mbetjeve pa miratimin e ministrisë;
   c) operatori i lejes braktis objektin e menaxhimit të mbetjeve;
   ç) operatori i lejes brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të rivlerësimit të garancisë financiare, nuk paraqet dokumentin e garancisë financiare të rivlerësuar;
   d) operatori i lejes nuk respekton kërkesat e planit të menaxhimit të mbetjeve;
   dh) nuk kryen detyrat e lëna nga struktura përgjegjëse, brenda afateve të caktuara në vendimin e pezullimit, në përputhje me nenin 27 të këtij ligji;
   e) operatori nuk i paraqet informacionet e kërkuara nga struktura përgjegjëse, paraqet informacione të pavërteta apo pengon strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të këtij ligji;
   ë) organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, ka revokuar lejen mjedisore;
   f) shkelen dispozitat e shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 6 ose pikës 4, të nenit 6.
2. Leja revokohet edhe me kërkesën e operatorit, kur:
   a) ka plotësuar të gjitha detyrimet e lejes;
   b) vazhdimi i operimit krijon premisa për rreziqe mjedisore.

Neni 29
Procedura e revokimit të lejes

1. Procedura e revokimit të lejes fillon:
a. me raportin e propozimit të strukturës përgjegjëse:
b. kërkesë të operatorit, kur ky i fundit ka plotësuar të gjitha detyrimet e saj.

2. Ministri, në bazë të propozimit të strukturës përgjegjëse, njofton operatorin e lejes, duke specifikuar qëllimin e tij për të revokuar lejen dhe arsyen e një veprimi të tillë. Njoftimi konsiderohet se është bërë, në rast se kanë kaluar 10 ditë kalendarike nga data e dërgimit me postë, në adresën që operatori ka deklaruar në përmbajtjen e lejes dhe nëse është publikuar në faqen zyrtare të ministrisë. Operatori ka të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes.
3. Ministri vendos revokimin e lejes 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Në rast se brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 2, operatori paraqet argumente dhe prova të mjaftueshme që provojnë mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, ministri vendos pushimin e procedurës së revokimit.
4. Në rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 28 të këtij ligji, operatori duhet të njoftojë strukturën përgjegjëse jo më vonë se 1 vit para datës, në të cilën kërkohet revokimi. Njoftimi përmban arsyet e detajuara të mbylljes, dokumentacionin tekniko–ekonomik dhe planin e aktualizuar të rehabilitimit. Me marrjen e kërkesës, njësia përgjegjëse inspekton zonën dhe harton një raport që ia paraqet ministrit.
5. Revokimi në të gjitha rastet vendoset nga ministri, në bazë të raportit të strukturës përgjegjëse.
6. Kundër vendimit të ministrit bëhet ankim në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 30
Detyrimet e operatorit pas revokimit të lejes

1. Pas revokimit të lejes, sipas nenit 29 të këtij ligji, operatori detyrohet të zbatojë planin e rehabilitimit.
2. Zbatimi i sanksioneve administrative të pezullimit apo revokimit të lejes nuk e liron operatorin nga detyrimet e këtij ligji dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kur revokohet leja, sipas parashikimeve të këtij ligji, ministri ndjek pa kufizim çdo të drejtë ligjore dhe ndërmerr çdo veprim ligjor, për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkeljet e operatorit.

KREU X
OBJEKTET E MBYLLURA DHE TË BRAKTISURA TË MBETJEVE MINERARE

Neni 31
Inventari i objekteve të mbyllura dhe të braktisura

1. Struktura përgjegjëse krijon, administron dhe përditëson inventarin kombëtar të objekteve të mbyllura dhe të braktisura të mbetjeve minerare që mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve ose mjedisin.
2. Inventari përmban të paktën:
   a) vendndodhjen e objektit;
   b) llojin e mbetjeve minerare;

c) vlerësimin paraprak të rrezikut;
ç) gjendjen teknike të objektit;
d) masat e nevojshme për monitorim, rehabilitim ose sigurim.

3. Inventari përditësohet periodikisht mbi bazën e monitorimeve, inspektimeve dhe të dhënave të reja.

Neni 32
Vlerësimi i rrezikut

1. Struktura përgjegjëse kryen ose urdhëron kryerjen e vlerësimit të rrezikut për objektet e mbyllura dhe të braktisura të mbetjeve minerare.
2. Kur nga vlerësimi rezulton se objekti paraqet rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e njerëzve ose mjedisin, struktura përgjegjëse propozon marrjen e masave për monitorimin, rehabilitimin dhe sigurimin e tij.

KREU XI
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 33

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 5, pika 6; nenit 8, pika 5; nenit 10, pika 4; nenit 14, pika 5; dhe nenit 17, pika 10, të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare të miratojë aktet nënligjore të përcaktuar në pikën 4 të nenit 7, në pikën 4 të nenit 19, në pikën 3 të nenit 21, në pikën 3 të nenit 25, në pikën 3 dhe pikën 5, të nenit 26, të këtij ligji.

Neni 34

Objektet ekzistuese

1. Operatorët që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ushtrojnë veprimtari të menaxhimit të mbetjeve minerare janë të detyruar të përshtatin veprimtarinë e tyre me kërkesat e këtij ligji brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij.
2. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 35
Shfuqizime dhe ndryshime

1. Në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 17, 18, të nenit 36 shfuqizohen.

b) Neni 38 shfuqizohet.

c) Shkronjat "c" dhe "d", të pikës 1, të nenit 17, shfuqizohen.

ç) Në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 18, togfjalëshi "dhe menaxhimi i mbetjeve", hiqet.

d) Në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 27, në shkronjën "dh", të pikës 1, të nenit 29 dhe në pikën 11, të nenit 36 togfjalëshi "dhe menaxhimin e mbetjeve minerare", hiqet.

dh) Në pikën 15, të nenit 36 togfjalëshi "dhe planin e menaxhimit te mbetjeve minerare", hiqet.

e) Në pikën 1, të nenit 37, togfjalëshi "të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare" dhe në pikën 2, të nenit 37, togfjalëshi "dhe planin e menaxhimit të mbetjeve minerare", hiqen.

f) Në shkronjën "ç", të pikës 1, të nenit 45, togfjalëshi "18 pika 1 shkronja "b" dhe togfjalëshi "27 pika 2 shkronja "a", hiqen.

g) Në shkronjën "f", të pikës 1, të nenit 45, togfjalëshi "neni 37, pika 2", hiqet.

h) Në shkronjën "e", të pikës 1, të nenit 47, togfjalëshi "e planit të menaxhimit të mbetjeve" hiqet.

i) Pika 1, e nenit 31, ndryshon si më poshtë vijon:

"*Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përllogaritet në vlerë monetare dhe përdoret nga zotëruesi i lejes ose shteti për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, si dhe për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, e cila mbulon realizimin e planit të mbylljes së veprimtarisë minerare dhe vlerësohet nga struktura përgjegjëse. Garancia financiare për mbylljen dhe rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve përcaktohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve minerare.*

Për grupin e mineraleve ndërtimore, vlera totale e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, si dhe garancinë financiare për mbylljen dhe rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve. Kjo vlerë vlerësohet nga struktura përgjegjëse.

Garancia financiare depozitohet pas marrjes së lejes minerare në datën efektive të marrjes së lejes dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të miratuar nga ministri, të viteve të jetëgjatësisë së lejes minerare dhe të sasisë së mineralit të programuar për t'u shfrytëzuar çdo vit, sipas planit vjetor të veprimtarisë minerare."

5. Në rast mos përputhjeje midis këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi, kanë përparësi dispozitat e këtij ligji.

Neni 36
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKSET
Aneksi I

Politika për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe informacioni për publikun.

Politika për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe informacioni që i vihet në dispozicion publikut.

1. Politika për parandalimin e aksidenteve të rënda
   a) Politika për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe sistemi i menaxhimit të sigurisë hartohen në përputhje me rrezikun e paraqitur nga objekti i mbetjeve minerare të kategorisë A.
   b) Politika për parandalimin e aksidenteve të rënda përcakton objektivat, parimet dhe masat e operatorit për identifikimin, parandalimin dhe kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të rënda.
   c) Sistemi i menaxhimit të sigurisë është pjesë e sistemit të përgjithshëm të menaxhimit të operatorit dhe përfshin strukturën organizative, përgjegjësitë, procedurat, proceset dhe burimet e nevojshme për zbatimin e politikës për parandalimin e aksidenteve të rënda.
   d) Sistemi i menaxhimit të sigurisë përfshin, të paktën:
      i. organizimin dhe përgjegjësitë e personelit, identifikimin e nevojave për trajnim dhe sigurimin e trajnimit përkatës, si dhe përfshirjen e punonjësve dhe, sipas rastit, të nënkontraktorëve;
      ii. procedurat për identifikimin dhe vlerësimin sistematik të rreziqeve të aksidenteve të rënda dhe vlerësimin e mundësisë së ndodhjes dhe pasojave të tyre;
      iii. procedurat për funksionimin e sigurt të objektit, përfshirë mirëmbajtjen e instalimeve, pajisjeve dhe menaxhimin e ndërprerjeve të përkohshme të veprimtarisë;
      iv. procedurat për menaxhimin e ndryshimeve që lidhen me projektimin, ndërtimin ose modifikimin e objekteve të mbetjeve minerare;
      v. procedurat për planifikimin e emergjencave, identifikimin e situatave të mundshme të emergjencës, hartimin, testimin dhe rishikimin periodik të planeve të emergjencës;
      vi. procedurat për monitorimin e performancës, verifikimin e zbatimit të politikës për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe sistemit të menaxhimit të sigurisë, raportimin, hetimin dhe marrjen e masave korrigjuese në rast të mosrespektimit ose të incidenteve;
      vii. procedurat për auditimin dhe rishikimin periodik të politikës për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe të sistemit të menaxhimit të sigurisë, si dhe për përditësimin e tyre.
2. Informacioni që i vihet në dispozicion publikut:
   Informacioni që i vihet në dispozicion publikut për objektet e mbetjeve minerare të kategorisë A përfshin, të paktën:
   a) emrin e operatorit dhe adresën e objektit të mbetjeve minerare;
   b) emrin ose funksionin e personit përgjegjës për dhënien e informacionit;
   c) informacionin që objekti i mbetjeve minerare funksionon në përputhje me kërkesat e këtij ligji;
   ç) një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë që zhvillohet në objekt;
   d) emërtimin ose klasifikimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme, si dhe të mbetjeve minerare që mund të shkaktojnë një aksident të rëndë, së bashku me karakteristikat kryesore të rrezikshmërisë së tyre;

dh) informacion të përgjithshëm mbi natyrën e rreziqeve të aksidenteve të rënda dhe pasojat e mundshme për njerëzit dhe mjedisin;
e) informacion mbi mënyrën e njoftimit të publikut në rast të një aksidenti të rëndë;
ë) informacion mbi masat që duhet të ndërmarrë publiku në rast të një aksidenti të rëndë;
f) informacion që operatori ka marrë masat e nevojshme për përballimin e aksidenteve të rënda dhe për bashkëpunimin me strukturat e emergjencës;
g) informacion mbi planin e jashtëm të emergjencës dhe mënyrën e bashkëpunimit me autoritetet kompetente në rast aksidenti;
gj) informacion mbi mënyrën dhe vendin ku publiku mund të marrë informacion shtesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial.

ANEKSI II
Karakterizimi i mbetjeve

Mbetjet, që do të depozitohen në një venddepozitim, duhet të karakterizohen në një mënyrë të tillë që të garantojnë stabilitet fizik dhe kimik afatgjatë të strukturës së venddepozitimit dhe të parandalojnë aksidentet e mëdha. Karakterizimi i mbetjeve duhet të përfshijë, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me kategorinë e venddepozitimit, aspektet e mëposhtme:

1. Përshkrimi i karakteristikave fizike dhe kimike të mbetjeve që do të depozitohen në afat të shkurtër dhe të gjatë, me fokus të veçantë ndaj stabilitetit të tyre në kushtet atmosferike/meteorologjike sipërfaqësore, duke marrë parasysh llojin e mineralit ose mineraleve që do të nxirren dhe natyrën e çdo mbulese dhe/ose mineralesh të thërrmuar që do të zhvendosen gjatë operacioneve nxjerrëse;

   1.1 Mbledhja dhe vlerësimi i informacionit.

   a) Procedura e mbledhjes së të dhënave:

   i. Përdorimi i informacionit ekzistues – studime, leje ekzistuese, harta gjeologjike, standarte europiane ose kombëtare për materiale të ngjashme;

   ii. Vlerësimi i cilësisë dhe përfaqësueshmërisë – identifikimi i informacionit që mungon;

   b) Marrja e mostrave – kur informacioni mungon, hartohet një plan mostrimi sipas standartit EN 14899, duke përfshirë:

   i. Qëllimin e mbledhjes së të dhënave;

   ii. Programin e testimit dhe kërkesat e mostrimit;

   iii. Situatat e mostrimit (drill-cores, faqe gërmimi, transportues, halde, pellgje, etj.);

   iv. Procedurat për numrin, madhësinë, masën, përshkrimin dhe trajtimin e mostrave;

   v. Vlerësimi përfundimtar – rezultatet e karakterizimit futen në planin e menaxhimit të mbetjeve.

   1.2. Kërkesat teknike për karakterizimin e mbetjeve.

   a) Përcaktimi i karakteristikave kimike, mineralogjike dhe gjeokimike të mbetjeve, si dhe çdo shtesë ose mbetjeje që gjendet në to;

   b) Përshkrimi i procesit kimik të drenimit në kohë, duke marrë parasysh trajtimin e parashikuar.

   c) Vlerësimi i tretshmërisë së metaleve, anioneve oksiduese dhe kripërave në kohë përmes:

   i. Testit të tretshmërisë në varësi të pH-së;

   ii. Testit të filtrimit;

iii. Testit të lëshimit në varësi të kohës;

iv. Çdo testi tjetër të përshtatshëm.

Për mbetjet, që përmbajnë sulfide, duhet të kryhen teste statike ose kinetike, për të përcaktuar drenimin acid në shkëmbinj dhe tretshmërinë e metaleve në kohë.

ç. Lloji dhe përshkrimi i metodës së nxjerrjes dhe procesit të aplikuar;

d. Natyra e produktit të synuar.

1.3. Konsiderata të përgjithshme të vendburimit:

a) Natyra e shkëmbinjve përreth, kimia dhe mineralogjia e tyre;

b) Natyra e vendburimit, përfshirë shkëmbinjtë dhe mineralizimin;

c) Tipologjia e mineralizimit, kimia dhe mineralogjia, përfshirë vetitë fizike (densiteti, poroziteti, shpërndarja e madhësisë së grimcave, përmbajtja e ujit);

ç) Madhësia dhe gjeometria e vendburimit;

d) Alterimet gjeokimike nga pikëpamja kimike dhe mineralogjike.

1.4. Mbetjet dhe trajtimi i parashikuar i tyre.

Përshkrimi i natyrës së të gjitha mbetjeve, që prodhohen në çdo operacion, përfshirë mbulesën, shkëmbinjtë e mbetur dhe shtresa vegjetale, shoqëruar me informacion mbi:

a) Origjinën e mbetjeve në vendin e nxjerrjes dhe procesin që i prodhon;

b) Sasinë e mbetjeve;

c) Sistemin e transportit të mbetjeve;

ç) Substancat kimike që përdoren gjatë trajtimit;

d) Klasifikimin e mbetjeve, përfshirë karakteristikat e rrezikshme;

dh) Llojin e objektit të parashikuar të mbetjeve, forma përfundimtare e ekspozimit dhe metoda e depozitimit;

1.5. Sjellja gjeoteknike e mbetjeve.

Parametrat për vlerësimin e karakteristikave fiziko-mekanike të mbetjeve:

a) Granulometria – shpërndarja e madhësisë së grimcave;

b) Plasticiteti – aftësia për të ndryshuar formën pa thyerje;

c) Densiteti dhe përmbajtja e ujit;

ç) Shkalla e kompaktësisë;

d) Forca në prerje dhe këndi i fërkimit të brendshëm;

dh) Përshkueshmëria dhe poroziteti;

e) Ngjeshmëria dhe kompaktësimi.

2. Klasifikimi i mbetjeve sipas zërave përkatës të Vendimit të BE 2000/532, duke marrë parasysh veçanërisht karakteristikat e rrezikshmërisë së tyre.
3. Përshkrimi i karakteristikave kimike, mineralogjike të mbetjeve, si dhe çdo shtesë ose mbetjeje që gjendet në to. Parashikimi i kimisë së drenimit në kohë, duke marrë parasysh trajtimin e parashikuar:

Vlerësimi i tretshmërisë së metaleve, anioneve oksiduese dhe kripërave në kohë përmes:

a) Testit të tretshmërisë në varësi të pH-së

b) Testit të filtrimit

c) Lëshimit në varësi të kohës

d) Çdo testi tjetër të përshtatshëm

Për mbetjet që përmbajnë sulfide – duhet të kryhen teste statike ose kinetike për të përcaktuar drenimit acid të shkëmbit dhe tretshmërinë e metaleve në kohës.

4. Përshkrimi i metodës/metodave të depozitimit të mbetjeve.
5. Sistemi i transportit të mbetjeve që do të përdoret.